



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prilapim / Predato Received / Delivered	08.09.2023	3	viti god year
Organ / Shkëmbim Org / Shkëmbim	Kr. Prot. Kr. Prot. No	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHIC G 028	2023		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1082/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1082/2023 të datës 15.08.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga \_\_\_\_\_, kundër Vendimit Nr.Prot: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1082/2023 e datës 15.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Vendimit me Nr. 3/05 të datës 21.05.2008 të u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë është caktuar në pozitën Udhëheqës për Regjime dhe Programe në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Më datë 25.04.2023 ankuesi përmes emailit nga \_\_\_\_\_ është njoftuar se pozita që mbani nuk është e paraparë ne Rregulloren QRK-NR.31/2013 për Organizmin e Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, andaj jemi të obliguar të shqyrtojmë mundësin e sistemimit në ndonjë pozitë tjetër për të cilën i plotësoni kriteret, ndërsa ankuesi përmes emailit të datës 27.04.2023 ka njoftuar përmes emailit z. \_\_\_\_\_ se pajtohet të sistemohet në pozitën Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Më datë 03.05.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 543 përmes të cilit ankuesi është sistemuar në pozitën Mbikëqyrës

Grada II në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ndërsa më datë 05.05.2023 për të njëjtën pozitë i është lëshuar Akt Emërimin AE.Nr.169/2023.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.Port: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes postës më datë 11.08.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 15.08.2023 është pranuar dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.1082/2023 me numër protokolli 5670/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 21.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 24.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:* Ankesën e ankuesit me numër protokolli 5670/2023 të datës 15.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Port: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt Emërimin AE.Nr.169/2023 të datës 05.05.2023; Kontratë Pune e datës 01.10.2006; Vendimin me nr. 3/05 të datës 21.05.2008 të u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë; Kontratë e punësimit e datës 01.08.2011; Kontratë për Kohë të Caktuar e datës 31.07.2019, 01.08.2014; Raport për vlerësimin e punës i datës 14.12.2010, 28.12.2012, 30.12.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 13.12.2018, 13.12.2019, 28.01.2022, 06.01.2023; Emailin e datës 25.04.2023 nga për Zarin e datës 11.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 24.08.2023; Emailin e datës 03.05.2023 nga Drejtoria e SHKK për ankuesin lidhur me dërgimin e vendimit; Emailin e datës 25.04.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 27.04.2023 nga ankuesi për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e parashtruar kundër Vendimit me Nr.Port: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1, 2,3 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30)

ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”, si rrjedhojë meqenëse ankuesi vendimin e kundërshtuar me këtë ankesë e ka pranuar përmes emailit më datë 03.05.2023.

Marr për bazë se ankuesi në ankesë pretendon se me Vendimin me Nr.Port: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit, konstaton e ky vendim përveç pjesëve të tjera të aktit administrativ i njëjti nuk përmban këshillën juridike se ku pala e pakënaqur mund të drejtohet me ankesë kundër aktit, si rezultat i kësaj kjo nuk është pengesë ligjore që pala e pakënaqur të filloj procedimin administrativ ndaj aktit, si rrjedhojë procedimi administrativ ndaj një akti i cili nuk ka këshillë juridike, respektivisht afati për kundërshtimin e një akti të tillë është tre muaj nga dita e pranimit të aktit.

Meqenëse ankuesit vendimin e kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimin me Nr.Port: 543 të datës 03.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, e ka pranuar përmes emailit më datë 03.05.2023 në orën 11:12, ndërsa ankesën ndaj këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar përmes postës më datë 11.08.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1082/2023, datë 08/09/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

